




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-510/2013
 Br. Prot. 01-510/2013
 Prot. No. 01-510/2013
 Nr. l.faq. 03
 Data 20.02.2013
 Broj stranica 03
 Datum 20.02.2013
 Nr. pages 03
 Date 20.02.2013

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.01.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-3636\12, për zyrtarin e lartë z.Isak Rakovica, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike “Hortikultura” për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dhënë dorëheqje nga funksioni si anëtarit i Bordit në Ndërmarrjen Publike “Kompania për Menaxhimin e Deponive”.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3636/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Isak Rakovica, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike “Hortikultura”.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike “Hortikultura”, ka qenë duke ushtruar edhe funksionin e anëtarit të Bordit në Ndërmarrjen Publike “Kompania për Menaxhimin e deponive” që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 22.10.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave me datën 05.11.2012, z. Isak Rakovica, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "Hortikultura" është ardhur në takim në zyrat e AKK-së, dhe na ka njoftuar se e ka marr shkresën njoftuese dhe dëshiron të njoftohet me detal për situatën që dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Gjatë takimit e kemi njoftuar për situatën që gjendet z. Rakovica, ku edhe ai vet është pajtuar se ushtron dy funksionet Publike, mirëpo është arsyetuar se nuk mendon që është në situatë që mundë të shkaktoj Konflikt të Interesit, ndërsa për këtë situatë nuk e ka njoftuar askush nga njësia për monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, se është në kundërshtim me ligjin në fuqi, mirëpo është pajtuar se do të konsultohet edhe me njësinë për monitorimin e Ndërmarrjeve Publike që ta sqaroj edhe një herë këtë situatë, dhe se do të shfrytëzoj të gjitha mundësit dhe në afatin ligjorë do të njoftoj Agjencinë, për hapat e marrë.

Me datën 07.11.2012, zyrtari i lartë z. Isak Rakovica, ka sjellë në Agjenci një shkresë ku edhe një herë e ka përshkruar situatën që mendon se nuk është në gjendje të mundshme të Konfliktit të Interesit, por ka thënë se pamarre parasysh deklaratën e tij dhe disa nga provat e ofruara ai do të pajtohet me çfarë do vendimi që merr Agjencia.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 17.12.2012, i ka dërguar shkresën e dytë njoftuese për konstatim të konfliktit të interesit dhe e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Rakovica, se brenda afatit të paraparë të marrë të gjitha hapat për ta shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj sipas nenit 18.8 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Isak Rakovica, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "Hortikultura" është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit me datën 04.01.2013, ku dhe ka sjellë deklaratën, që ka paraqitur dorëheqjen nga posti i Anëtarit të Bordit në Ndërmarrjen Publike "Kompania për Menaxhimin e Deponive" para organeve kompetente.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve dhe në bazë të gjendjes së krijuar në këtë proces konstatojmë se :

Zyrtari i lartë, z. Isak Rakovica, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "Hortikultura", nuk gjendet në situatën e përshkruar si Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit Publik pasi që ka ofruar dorëheqjen për pozitën anëtarit të bordit në Ndërmarrjen Publike "Kompania për Menaxhimin e Deponive".

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës, dhe funksionit publik të anëtarit të bordit në Ndërmarrjen Publike "Kompania për Menaxhimin e Deponive".

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

